



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 28 qershor 2018, në mbledhjen e III-të (tretë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.35’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Floretë Zejnullahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave - DBF, Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës - DA, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - DSHPMSh, Agim Blakqori, UD i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit - DKA, Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - DPZHE, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, dhe Driton Nuli përfaqësues i OSBE-së

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhje, përshëndeti të pranishmit, dhe shtoi, besoj se materialet i keni marr me kohë, dhe shtoi, nëse ndokush prej anëtarëve keni diçka rreth rendit të propozuar të ditës, mund ta merrni fjalën, nëse jo e hedh në votim sipas materialit të dërguar.

z.Fitmi Haziri, theksoi, para disa ditëve ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e kemi bërë një kërkesë me shkrim e cila nuk është përfshirë në rend dite, andaj kërkoj ta dijë se a është shqyrtuar apo jo, fjala është për kërkesën për emërtimin e një sheshi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, përgjigje parafolësit, ne e kemi marrë atë kërkesë, e kemi analizuar dhe kemi vërejtur se një kërkesë e tillë duhet të iniciohet nga Drejtoria përkatëse dhe janë disa procedura të cilat duhet të respektohen në rastet e emërtimeve të zonave të qarkullimit publik. Sot drejtori i Drejtorisë përkatëse mungon për shkak se ka rast vdekjeje por prezent është drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit i cili është paksa në rrjedha dhe mund të na jap sqarime më konkrete.

z.Durim Salihu, drejtor i DI, theksoi, çështja e emërimit të rrugëve rrugicave dhe shesheve në këtë rast shkon përmes Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e cila ka të drejtën e marrjes së emrave të rrugëve rrugicave dhe shesheve në listën rezervë e cila është miratuar me rastin e emërimit të rrugëve, pra çdo emërtim i ri duhet të merret nga lista rezervë e emrave.

Në bazë të Ligjit për sistemin e adresave, për çdo emërtim të ri duhet t'i drejtoheni DPUMM e cila është kompetente për zhvillimin e procedurave përkatëse ku fillimisht emrat duhet të merren nga lista rezervë.

z.Fitmi Haziri, theksoi, ne kemi bërë kërkesë me shkrim dhe nuk na është kthyer asnjë përgjigje dhe nuk kemi sqarim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, kërkesa është për përfshirje në rend të ditës kjo çështje. Nuk e kam përfshirë në rend të ditës sepse e kam parë të arsyeshme që të debatojmë në KPF dhe në Kuvend për këtë çështje sepse në bazë të asaj që kam hulumtuar janë disa procedura ligjore dhe nënligjore të cilat duhet të përfillen paraprakisht.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk kam qenë në dijeni për një kërkesë – propozim të tillë, por jemi në dijeni se emrat e rrugëve duke përfshirë edhe listën rezervë janë miratuar në mandatin e kaluar ku ka qenë një komision i veçantë për këtë çështje i përbërë nga përfaqësuesit e secilit subjekt të përfaqësuar në Kuvend. Sa jam në dijeni çdo rrugë apo shesh i ri duhet të emërtohet me një emër nga lista rezervë, kurse sa i përket ndonjë emri të ri jashtë kësaj liste t'ju them të drejtën na duhet kohë ta konsultojmë ligjin më në detaje, andaj mendoj se për këtë çështje do të ishte mirë që në ndonjë seancë tjetër kur është edhe drejtori i Drejtorisë përkatëse prezent të jepen sqarime dhe përgjigje konkrete.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, sa për sqarim, lexoi nenin 7 të Ligjit për sistemin e adresave, *ku thuhet, emrat për Zonat e qarkullimit publik propozohen nga drejtoria komunale përgjegjëse, emrat vendosen me vendim të Kuvendit të Komunës. Emrat e zonave të qarkullimit publik synojnë të ruajnë vazhdimësinë dhe homogjenitetin në aspektin kulturorë dhe historik që synojnë të jenë të propozuara duke marrë në konsideratë gjithë procesin konsultativ me komunitetin që jetojnë në zonat e qarkullimit publik*, do të thotë që çdo herë duhet të merret edhe pëlqimi i banorëve të cilët jetojnë në zonat përkatëse, pastaj thuhet, *emrat e zonave të qarkullimit publik regjistrohen në regjistrin komunal të adresave*.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, kjo që e tha Kryesuesi ka qenë edhe procedura të cilën e ka ndjekur komisioni në mandatin e kaluar ku edhe unë isha pjesë e tij.

z.Durim Salihu, drejtor i DI, vetëm edhe një sqarim shtesë dua ta bëjë meqë në kohën kur është bërë emërtimi i zonave të qarkullimit publik kam qenë drejtor i DPUMM. Ashtu siç është e rregulluar edhe me ligj, janë zhvilluar diskutimet publike me qytetarë qoftë në zona urbane qoftë rurale, janë marrë propozimet, kanë kaluar nëpër të gjitha procedurat duke përfshirë edhe arsyeshmërinë e propozimeve ku të njëjtat janë shqyrtuar dhe votuar në Komisionin përkatës i cili pastaj të njëjtat i ka proceduar për shqyrtim në Kuvendin e Komunës ku janë shqyrtuar dhe miratuar të gjitha propozimet duke përfshirë edhe listën e emrave rezervë. Me ligj përcaktohet shumë qartë se nuk mund të ndërrohet asnjë emër i ndonjë rruge, rrugice apo sheshi përderisa për të njëjtën ekziston emri përkatës me vendim të Kuvendit të Komunës, ndërsa për rrugët, rrugicat ose sheshet e reja që krijohen, emrat duhet të merren nga lista rezervë, e jo jashtë listës.

z.Fitmi Haziri, theksoi, kërkesa jonë është për shëtitoren përkaj lumit Llap, nga xhamia e qytetit në drejtim të urës së re.

z.Durim Salihu, drejtor i DI, me ligj kërkohet emërtimi vetëm për rrugë, rrugica, bulevarde dhe sheshe, kurse shëtitoret nuk i njeh.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, për hir të transparencës po ndërhyj edhe pse nuk është drejtori i Drejtorisë përkatëse prezent i cili me arsye mungon sepse ka rast të vdekjes. Andaj do të ishte mirë që ndokush nga Ekzekutivi i Komunës ta shqyrtoj kërkesën sa i përket legjislacionit dhe të kthej përgjigje.

z.Fitmi Haziri, theksoi, edhe ne po e kërkojmë një përgjigje sepse me ligj është e paraparë që brenda 7 ditëve të kthehet përgjigja në kërkesë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, kërkesa në fjalë nuk ka të bëjë me kthim përgjigjeje, por ka të bëjë me përfshirje në kuadër të rendit të ditës, dhe për faktin që nuk kam mund ta përfshijë në rend të ditës unë e hapa këtë debat në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje rreth kësaj çështje. Pra DPUMM është

kompetente për çështjen në fjalë të cilën edhe e kam informuar për këtë kërkesë por në rend dite nuk ka mund të përfshihet për këto arsye që i ceka.

z.Fitmi Haziri, theksoi, ka një muaj që është bërë kërkesa dhe nuk po mund të marrim një përgjigje, andaj shtroj pyetje, si po mbetet për hapat e mëtutjeshëm.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, drejtori i Drejtorisë përkatëse do të jep sqarimet për hapat e mëtutjeshëm, sepse është ajo Drejtori e cila është edhe impelmentuese e Ligjit për Sistemin e Adresave.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne kemi bërë edhe një kërkesë tjetër me shkrim në një prej seancave, që ka të bëjë me fasadën e objektit të palestrës sportive tek Gjimnazi, e që nuk kemi marrë përgjigje deri tani.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, edhe për këtë kërkesë mendoj se në seancën e radhës duhet të jep përgjigje drejtori i Drejtorisë përkatëse. E them këtë sepse të gjithë Drejtorët janë të obliguar që pyetjeve të këshilltarëve të Kuvendit, t’iu kthejnë përgjigje, qoftë me shkrim qoftë në foltore.

z.Fitmi Haziri, theksoi, gjithashtu rreth rendit të ditës, në seancën e kaluar kemi pas një kërkesë për përfshirje të pikës, Pyetje dhe përgjigje, në rend të ditës, propozimin ky i Grupit të këshilltarëve të PDK-së, andaj kërkoj të diskutohet kjo në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje që kjo pikë të përfshihet në rend dite në seancat e Kuvendit. Çështje e cila ka mbet të diskutohet në takimin e radhës, përkatësisht sot.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, nuk po dëshiroj të luaj rolin e avokatit, por ne jemi këtu dhe mund të diskutojmë këtë. Ne e kemi një Rregullore të punës së Kuvendit e cila i rregullon të gjitha çështjet që ndërlidhen me seancat e Kuvendit, pika të ndryshme, është pikë e cila jep hapësirë dhe mundësi për të gjitha pikat tjera për pyetje, sqarime etj etj.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rreth kësaj çështje mendoj se për pyetjet që shtrohen nuk mund të bëhen përgjigje aty për aty, me përjashtim të ndonjëres. Përgjigjet nga ana e drejtorëve të Drejtorive mund të kthehen brenda muajit apo në mbledhjet e radhës, sepse vërtetë përgjigjet marrin kohë ngase duhet të jenë profesionale dhe në harmoni me legjislacionin dhe kompetencat e Drejtorisë përkatëse, mirëpo nëse një drejtori i shtrohen pyetje dhe nuk e ndjen obligim të kthej përgjigje nuk mendoj se është në rregull.

z.Fitmi Haziri, theksoi, lidhur me këtë çështje ne në mbledhjen e kaluar e kemi ndërprerë seancën për pak minuta dhe kemi biseduar shifat e Grupeve të këshilltarëve ku jemi dakorduar që këtë çështje ta diskutojmë në mbledhjen e ardhshme të KPF-së, përkatësisht në këtë mbledhje.

z.Avni Fetahu, theksoi, është e vërtetë ajo që e tha parafolesë që ne e kemi diskutuar këtë çështje dhe e kemi lënë të diskutojmë në këtë mbledhje të KPF-së. Ne jemi interesuar dhe kemi parë se në nenin 52 të Rregullores ku bëhet fjalë për pyetjet e këshilltarëve të Kuvendit është e definuar qartë se pyetjet e këshilltarit të Kuvendit shtrohen në kuadër të rendit të ditës, Çështje tjera, andaj mendoj se nëse ne vazhdojmë t’i imitojmë disa Komuna të caktuara mund të bëhemi pre e disa faqeve siç është “kuku news” e të ngjashme dhe ndoshta të shndërrohemi si shaka gjatë ushtrimit të punëve tone, mirëpo është mirë dhe ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së jemi këmbëngulës që pyetjet që ju parashtrohen drejtorëve të Drejtorive, dhe nuk kthehen përgjigjet, do ta keni edhe përkrahjen tonë për arsye se për këtë ata janë të obliguar të japin përgjigjet dhe për arsyen se nëse nuk kthehen përgjigjet do të ishte e dëmshme edhe për neve si subjekt politik, përndryshe edhe ne e përkrahim atë që në pikën të ndryshme të parashtrohen pyetjet dhe të jemi këmbëngulës që të kthehen përgjigjet, por jo të bëhet diçka e veçantë që pastaj mund të dalim ndodhin shaka me ne.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, si përfundim po mbetet që fundja nuk ka edhe shumë rëndësi sepse nëse ne shtojmë pikën, Pyetje përgjigje, në rend të ditës, po rezulton se është vetëm një paragraf më shumë në rend të ditës dhe asgjë më shumë. E dëgjova edhe vullnetin e z.Rafet Llapashticës por edhe qëndrimin tonë si subjekt politik – LDK, mirëpo e rëndësishme është që të gjejmë forma dhe modalitete përmes të cilave ne si këshilltarë të Kuvendit të Komunës e ushtrojmë presionin për kthimin e përgjigjeve, sepse pika të ndryshme është mëse e mjaftueshme për të paraqitur pyetje qoftë këshilltarët nga opozita qoftë

edhe ne si pozitë, dhe këtë e bazoj edhe në praktikën e mëparshme ku secili këshilltarë çdo herë ka qenë i lirë të parashtoj pyetje dhe të ngritë çështje të ndryshme në pikën e rendit të ditës, të ndryshme.

z.Fitmi Haziri, theksoi, e ngrita këtë çështje sepse ne në seancën e kaluar të Kuvendit ne diskutuam këtë çështje dhe mbeti si konstatim që të diskutohet më detajisht në mbledhjen e KPF-së, andaj nëse sot të vepronim vetëm ashtu pa diskutuar për këtë çështje nuk do të ishte në rregull dhe disi ne pastaj po dalim si jo të singertë.

z.Mehmet Gashi, theksoi, për nga përvoja ime, veçmas nga mandati i kaluar që kam qenë Kryesues i Kuvendit, në kuadër të rendit të ditës ka qenë pika, Të ndryshme, në të cilën këshilltarët gjithëherë kanë mund të paraqesin pyetje dhe të ngritin çështje të ndryshme ku pastaj janë dhënë përgjigje dhe sqarime të nevojshme nga ana e Ekzekutivit të Komunës, çështje kjo e cila është e rregulluar edhe me Rregullore të punës së Kuvendit, përkatësisht është e drejtë e çdo anëtar/eje të Kuvendit të Komunës që deri në dy pyetje t'i parashtoj në Kuvend, kur ka ndonjë çështje të rëndësishme, mirëpo është edhe e drejtë e drejtorëve të Drejtorive që në raste se nuk është përgatitur të jap përgjigjen aty për aty, mund ta bënë një gjë të tillë në seancën e radhës së Kuvendit, por gjithëherë ka qenë praktikë që përgjigjet të kthehen nga ana e drejtorëve të Drejtorive, shembull, nesër në mbledhjen e Kuvendit mund të jepen përgjigjet për pyetjet e parashtruar në mbledhjen e kaluar duke përfshirë edhe ato nga seancat tjera. pra janë disa Komuna të cilat e kanë në rend të ditës pikën në fjalë, por kjo është varësisht rregullimit të vet Komunave e që ne e kemi të rregulluar me Rregullore të punës dhe askush në Kuvend nuk mund t'i ik një çështje të tillë, por po e përsërisë atë që edhe z.Avni Fetahu e potencoj se secili drejtor duhet të jetë serioz dhe të kthej përgjigjet në mbledhjen e radhës.

z.Fitmi Haziri, theksoi, unë do ta arsyetoja edhe z.Fatmir Rudarin për këtë çështje të ngritur sepse tani jemi në muajin e gjashtë dhe janë disa mbledhje në të cilat janë parashtruar pyetje nga ana e këshilltarëve dhe pothuajse asnjëherë nuk janë kthyer përgjigjet nga ana e drejtorëve të Drejtorive, mund të ndodh ndonjë përgjigje që është kthyer aty për aty, çështje për të cilën mendoj se është shqetësuese.

z.Mehmet Gashi, sqarim, nëse ndokush nuk merr përgjigje, ai mund të ngritët dhe të thotë se në mbledhjen e kaluar kam shtruar pyetje por nuk kam marrë përgjigje, çështje kjo e cila pastaj konstatohet madje edhe regjistrohet, hyn në procesverbal dhe mund ta dëgjoj edhe Ministria përkatëse deklarimin t'uaj sepse mbledhjet monitorohen, dhe është një papërgjegjësi nëse dikush nuk jap përgjigje.

z.Fatmir Gashi, **Kryesues**, theksoi, ndoshta tejkaluam paksa Rregulloren e punës së Kuvendit por qëllimi ishte që të debatojmë dhe të gjejmë një zgjidhje për këto çështje. Konsideroj se u sqaruam mjaftueshëm dhe si konstatim apo rekomandim mund të dalim se përgjigjet nga ana e drejtorëve të Drejtorive është mirë të kthehen në seancat e radhës së Kuvendit.

Tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit të dërguar.

Pas votimit u konstatua se rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri, me konstatim që për pyetjet e këshilltarëve të Kuvendit, përgjigjet të kthehen nga ana e drejtorëve të Drejtorive në seancat e radhës.

1. Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 10 maj 2018

Njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit.

2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Podujevës 2019 – 2021

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, siç jeni në dijeni me 15 maj 2018 Ministria e Financave ka lëshuar Qarkoren Buxhetore 2019/01 e cila përcakton kufijtë fillestar rreth fillimit të punës për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2019 dhe projeksionet për 2020/2021. Me të marrë këtë dokument Ekzekutivi i Komunës menjëherë ka filluar përgatitjet për hartimin e KAB si një dokument kornizë dhe strategjik i Komunës me të cilin bëhen planifikimet për periudhën trevjeçare. Bazuar në Qarkoren buxhetore 2019/01 Komuna e Podujevës për vitin 2019 do të ketë një buxhet prej 22,032,617.00 €, e që krahasuar me vitin paraprak është një ngritje jo shumë e madhe por që vërehet se ka ngritje. Karakteristikë e kësaj Qarkoreje është se në të gjitha departamentet, si në grant të arsimit, në shëndetësi dhe të tjera ka pasë ngritje por për ne Komunën ka qenë shqetësuese sepse me këtë kornizë parashihet se në vitin e ardhshëm përkatësisht viti shkollorë 2018/19 të ketë zvogëlim në Drejtorinë e Arsimit për 60 punëtorë, kjo ka qenë një prej brengave më të mëdha për të cilën kemi reaguar si Ekzekutiv i Komunës, por megjithatë deri në këtë fazë kërkesat ose ankesat tona nuk janë aprovuar, mirëpo si dokument i tillë ka mbet që Drejtoria e Arsimit të bënë një zvogëlim të stafit të punëtorëve, konkretisht 60 punëtorë të largoj nga puna. Edhe në mbledhjen e fundit të kolegjiut për buxhet dhe financa, pothuajse të gjitha Komunitatet e Kosovës kanë pasë të njëjtën vërejtje për zvogëlim të stafit të punëtorëve arsimor, dikush në numër më pak dikush më shumë, dhe kemi dal njëzëri me një rekomandim me të cilin ju kemi drejtuar Ministrisë së Financave që ky zvogëlim i stafit të mos bëhet kështu në mënyrë drastike apo thënë ndryshe të mos bëhet në mënyrë të menjëhershme në vitin 2019, por të bëhet vit pas viti në mënyrë proporcionale që shembull, Komuna e Podujevës në vitin 2021 të arrijn largimin e numrit të punëtorëve arsimor 60, përkatësisht nga 20 punëtorë për tri vitet e ardhshme, dhe tani mbetet të shihet se si do të veprojnë Ministria e Financave dhe Komisioni i ndarjes së Grantëve dhe lejim të numrit të stafit të punëtorëve, andaj mbesim me shpresë që do të hasin në mirëkuptim edhe kërkesat e Komunitatëve dhe që Ministria e Financave dhe Komisioni i cekur të kenë parasysh këtë në mënyrë që të mos shkaktoj kaos në arsim ku përnjëherë brenda vitit të zvogëlohet numri për 60 punëtorë. Konsideroj se në Qarkoren 2019/02 edhe kjo çështje do të definohet, por nëse mbetet kështu siç është vërtetë do të mbetet breng mjaft e madhe për drejtorin dhe Drejtorinë e Arsimit se si do të veprojnë në vitin 2019.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti Ekzekutivi i Komunës ka mbajtur edhe tri (3) dëgjime publike me qytetarë, një në fshatin Kërpimëh me fshatrat e atij rajoni nga Bajçina deri në Zhiti, takimi tjetër është mbajtur në fshatin Llluzhan me fshatrat përreth ku jemi munduar t'i përfshijmë fshatrat nga Gllamniku – Lupçi dhe fshatrat e rajonit të Orllanit, si dhe takimi tjetër është mbajtur në këtë sallë të Kuvendit ku ftesa ka qenë për qytetin dhe fshatrat përreth qytetit që nuk kanë qenë të ftuara në takimet paraprake, por megjithatë ka qenë takim publik dhe kanë mund të marrin pjesë edhe qytetarë të fshatrave tjera të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë mund të jenë pjesëmarrës në takimet paraprake. Në bazë të mundësive buxhetore ne jemi munduar t'i përfshijmë kërkesat të cilat i kemi vlerësuar se janë me prioritet dhe duhet të futen në listën e prioritetëve, duke pasur parasysh se është e pamundur që të përfshihen të gjitha kërkesat e qytetarëve në këtë dokument. Edhe një herë po e përsëris se ky është një dokument kornizë, mirëpo dokument i saktë i cili do të na shërbejë ta kemi projektbuxhetin për vitin 2019 dhe projeksionet për 2020/2021 do të jetë Qarkoja Buxhetore 2019/02 ku do të përcaktohen kufijtë final duke përfshirë edhe kufijtë e përcaktuar edhe nëpër kategori ekonomike, por në këtë fazë ku jemi ne si Komunë kemi qenë të lirë të planifikojmë qysh ne mendojmë se duhet të jetë, si kërkesa tonat reale në secilën kategori ekonomike ashtu si ne e kemi vlerësuar se duhet të jetë, por ky dokument sigurisht që do të pësojë ndryshime me Qarkoren 2019/02 dhe atëherë do të jemi të detyruar t'i respektojmë ata kufij.

Për fund, në këtë dokument kemi hasë në disa gabime teknike të cilat janë bërë gjatë hartimit në listën e projekteve të cilat në nëse pajtoheni po i dorëzoj në formë të shkruar por edhe në pika të shkurtër po i

lexoj (lexon korrigjimet që duhet bërë të cilat kanë të bëjnë me bartjen dhe harmonizimit të disa shumave në projekte të caktuara), dhe shtoi pra nuk bëhet fjalë për heqje të projekteve por vetëm barazim i shumave në projekte të caktuara duke u bazuar në kufijtë buxhetor.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahi këtë dokument që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim. Sigurisht ka për çka të diskutohet në Kuvend, mirëpo në aspektin personal po i cekë disa pika këtu, realisht kam pritur që Drejtoria e Arsimit, ajo e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të kenë një buxhet më meritore, shembull tek Drejtoria e Arsimit, për ndërtimin e fushave sportive kemi 20,000.00 € grant, që mendoj se më mirë do të ishte të figuronte, ndërtimi i fushës sportive, përderisa disa Drejtori janë ngarkuar me grante e që nuk kanë qenë asnjëherë, është dashtë që edhe për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të ngritët buxheti sikurse që është dashtë të ngritët edhe në fushat e shëndetësisë dhe të arsimit në mënyrë që t'i japim një shembull të mirë edhe nivelit qendrorë duke i dërguar sinjale që ka ardhur koha e fundit që të mendohet më shumë për këto dy fusha dhe t'i ikim paksa asfaltit sepse shumë shpejtë do të vijnë zgjedhjet dhe do të ballafaqohemi sërish me ato kërkesa të qytetarëve. Po ashtu kam vërejtur edhe një gjë, për të cilën edhe kam sugjerim, fjala është tek plani i propozuar për adresimin e mundësive të kërcënimeve tek aktivitetet e propozuara për të ardhmen në kuadër të DPZHE, ka qenë një hartë informative shumë funksionale deri në një kohë kurse tani në mungesë të një buxheti shumë modest tani ajo hartë nuk është funksionale, këtu është propozuar si adresim i mundësive për të ardhmen ndërsa në buxhet nuk figuron asnjë shumë e ndarë për të aktivizuar atë, andaj është mirë të ndahet buxhet për një gjë të tillë dhe të aktivizohet një hartë e tillë e cila do të ishte e mirë edhe për investitorët por edhe për qytetarët në përgjithësi.

z.Fitim Haziri, theksoi, mënyra e prioriteteve që është dhënë në këtë dokument mendojmë se nuk është bërë drejtë sepse janë disa fusha të cila kanë ngecje siç janë shëndetësia arsimit dhe zhvillimi ekonomik, por edhe tani fokusimi më i madh ende vazhdon të mbetet në asfalte, kanalizime, pastaj nuk kemi vërejtur se është bërë një hartim strategjik për zhvillim, madje Drejtoria përkatëse ka paraparë që në vitin 2019 të bëhet një strategji e tillë. Pastaj kemi Drejtori të cilat vetëm e kanë bartë buxhetin e njëjtë si në vitin 2019 ashtu 2020 dhe 2021 ku është i njëjti buxhet, kështu që vërejtjet tjera do t'i paraqesim nesër në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, përndryshe jemi kundër këtij planifikimi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në fakt ne rekomandojmë që ky dokument të shqyrtohet dhe diskutohet në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe opinionin tonë si Grup i këshilltarëve të PDK-së do ta japim nesër mirëpo brenda dokumentit përveç vërejtjeve që i bëri drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ne sigurisht që do të paraqesim edhe propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet tona rreth planifikimeve buxhetore për 3 vitet e ardhshme, përndryshe si dokument jemi që t'i rekomandohet Kuvendit për debat.

z.Mehmet Gashi, theksoi, dihet që me legjislacionin në fuqi KPF është përgjegjëse për shqyrtimin e të gjitha politikave financiare dhe dokumenteve strategjike financiare duke përfshirë edhe Kornizën Afatmesme Buxhetore andaj është mirë që ne si KPF ta kemi parasysh këtë, dokument ky i cili bazohet edhe në bazë të Qarkores Buxhetore të nivelit qendrorë e cila përcakton dhe kufizon kufijtë apo limitin buxhetorë të Komunave, përndryshe do të planifikohej më shumë buxhet dhe projekte por që nuk lejohet. Gjithashtu janë edhe dokumentet tjera strategjike komunale siç është Plani Zhvillimor Komunal, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e cila në vitin 2019 duhet të hartohet e re përkatësisht të rifreskohet me projekte dhe planifikime tjera të reja, po ashtu jam në dijeni se edhe debatet publike të zhvilluara janë marrë për bazë nga ana e Ekzekutivit, por edhe ne qoftë në këtë Komitet qoftë edhe nesër në mbledhjen e Kuvendit kemi të drejtë të propozojmë projekte dhe të paraqesim nevojat e qytetarëve për përfshirje në projektbuxhet, natyrisht kur kërkesat dhe propozimet janë të arsyeshme sigurisht që përfshihen por nuk mund të tejkalohet shuma apo limiti i përcaktuar nga niveli qendrorë.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, sa i përket asaj që u tha se buxheti është i planifikuar vetëm për asfalt, jua rikujtoj se kemi mbajtur tri dëgjime publike dhe konkretisht kërkoj që nesër t'ju shpërndahen

procesverbalet nga ato dëgjime, e që për fat të keq asnjë propozim – kërkesë tjetër nuk është bërë përveç asfaltit dhe kanalizimit, por ne sërish kemi dal jashtë atyre kërkesave duke ditur prioritetet e qytetarëve edhe pse të njëjtat nuk i paraqesin dhe në këtë projektbuxhet kemi paraparë edhe projekte tjera. Për arsim të gjithë jemi në dijeni se është kompetencë e nivelit qendrorë, përkatësisht Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT, dhe a mund të besoni që me Qarkoren buxhetore 2019/01 të Ministrisë së Financave, për arsimin në Komunën e Podujevës janë të caktuara vetëm rreth 130.000.00 €, mirëpo edhe përkundër kësaj ne kemi planifikuar që në vitin 2019 të fillojmë ndërtimin e objektit të ri të shkollës në fshatin Metehi ku kemi ndarë fillimisht 220,000.00 €, pastaj është projekti i MASHT për ndërtimin e shkollës në fshatin Llaushë në vitin 2019 dhe shpresojmë të ndërtohet, mandej planifikojmë që në vitin 2020 të fillojmë edhe me ndërtimin e shkollës së re në fshatin Balloc. Po ashtu në shëndetësi kemi rritje të buxhetit, pastaj kemi ndarë buxhet të ri prej 120,000.00 € për Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc dhe për dy vitet tjera të ardhshme nga 100,000.00 € në mënyrë që brenda kësaj periudhe ajo lagje të rregullohet në tërësi, pra po flasë për diçka që vitet tjera nuk ka qenë kështu por kemi pasuar Memorandume me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ku kjo ka ndarë mjete për ndërtimin e shtëpive kurse ne si Komunë kemi rregulluar gjithë infrastrukturën përcjellëse duke përfshirë edhe pronën, ndërsa në tri vitet e ardhshme kemi ndarë buxhet dhe presim ta përfundojmë ne vet si Komunë. Gjithashtu edhe përkundër kërkesave dhe propozimeve nga dëgjimet buxhetore, ne edhe në Drejtorinë e Bujqësisë Pyltlarisë dhe Zhvillimit Rural kemi planifikuar buxhet për investime kapitale, përkatësisht fillimin e ndërtimit të një pende për ujitjen e tokave bujqësore, përkatësisht në fshatin Repë ku pastaj do të ujitjen tokat e fshatrave Kërpimeh, Metehe, Zakut etj, si dhe kemi projektin tjetër të cilin do të fillojmë në vitin 2019 që është, analizat e tokës, që do t'ju shërbej të gjithëve për informacione rreth mbjelljeve të kulturave të ndryshme. Sa i përket funksionimit të Hartës Informative e cila është në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, është një buxhet i cili nuk kërkon të jetë projekt kapital dhe i lartë, por mund të jetë një buxhet simbolik nga kategoria e shërbimeve e që pa kurrfarë problemi mund të specifikohet në fazën e dytë të projektbuxhetit të Komunës. Kështu që nëse ne jemi të obliguar të marrim kërkesat dhe propozimet e qytetarëve dhe nëse nisemi nga ai parim se çka ata kanë propozuar dhe kërkuar, në këtë dokument asgjë tjetër përveç asfaltit dhe kanalizimit nuk do të kishte, mirëpo ne kemi planifikuar edhe projekte tjera si; shkolla, ambulanta, pajisje mjekësore, penda, analiza të tokës, ndërtim të një objekti për qendër rinore - biblioteke - shtëpie të kulturës etj, pra një spektër më i gjerë se siç u tha vetëm asfalt dhe kanalizim. Pra edhe njëherë e përsërisë, kërkesat e qytetarëve janë për asfalt dhe kanalizim të rrugëve dhe rrugicave nga 20 deri në 150 m kryesisht, e që mund t'i lexoni dhe të vëreni edhe ju vetë në procesverbalet nga ato takime që edhe njëherë kërkoj nga shërbimi i Kuvendit t'jua shpërndaj nesër para mbledhjes së kuvendit.

z.Fitim Haziri, theksoi, rreth dëgjimeve buxhetore, lind pyetja se sa ka qenë pjesëmarrja e qytetarëve, madje në bazë të fotove që shihen nga dëgjimi buxhetor në këtë sallë del se pjesëmarrja ka qenë shumë e vogël si dhe cili ka qenë niveli i atyre që kanë marrë pjesë (në aspektin edukativ), pastaj tani po e di se ka pas dëgjime buxhetore në Kërpimeh dhe Lluzhan, do të thotë që lajmërimi dhe informimi i qytetarëve nuk po bëhet si duhet në mënyrë që të gjithë qytetarët e interesuar të jenë pjesëmarrës dhe të paraqesin kërkesat e tyre. Kur e thash që ka “copy paste” të planifikimit buxhetor, kemi të bëjmë shembull me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe kjo tregon se buxheti ndahet i njëjtë për tri vitet e ardhshme, pra nevojat janë të mëdha për këtë Drejtori kurse ju nuk keni bërë rritje të buxhetit në mënyrë që të rinjtë tani të mos shkojnë në Prishtinë për çdo aktivitet që kanë nevojë në këto tri fusha, mandej kemi shumë klube sportive të cilat kanë qenë shumë më mirë në të kaluarën se sa tani ku disa prej tyre vetëm janë duke u shuar, kurse nuk është planifikuar asgjë për t'i ngritur ato.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, përgjigje parafolësit, nuk qëndron ajo që u tha sepse buxheti është i njëjtë por jo edhe projektet, dhe kjo ka dallim, pastaj mund ta merrni me mend në çfarë kushtesh ka funksionuar Klubi Futbollistik Llapi para dy viteve, dhe çfarë ka tani, madje dje në portalin e juaj Llapi.info keni shkruar se tribunat e KF Llapi po marrin një pamje moderne, andaj të gjitha ato janë investime që i bëjmë. Pra ne kemi ftuar në dëgjime buxhetore të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës, nuk kemi bërë dallime, intelektual, të shkolluar etj etj, e them këtë si përgjigje në kontekst të asaj që parafolësi e tha se çfarë niveli kanë qenë pjesëmarrësit, pra ka qenë ftesë publike, pa dallime dhe pa kufizim të numrit të pjesëmarrësve, pa detyrime dhe pa nxitje për pjesëmarrje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, e falënderoj drejtorin për informatat, sqarime dhe prezantimin e KAB-it, dhe anëtarët tjerë për kontributin e tyre. Nuk dëshiroj të bëjë politikë por të gjithë duhet të angazhohemi që t'i nxitim qytetarët për pjesëmarrje në takime të tilla publike, pastaj të mundohemi sa më shumë të ngritim nivelin politik, edukativ dhe të tjera, dhe kjo të merret si vërejtje nga këshilltari zotëri Haziri, pastaj të jetë për të gjithë ne sepse fajin më të madh e kemi ne ngase kemi hyrë në politikë për të ngritë cilësinë dhe nivelin politikë.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, informimi nuk është transparent absolut, këtë e kam ngritë edhe si çështje kur kemi pas të bëjmë me debatin publik me qytetarë për Statutin e Komunës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, përgjigje parafolëses, informimi nga institucionet, në këtë rast nga ana e Komunës bëhet për qytetarët e Komunës së Podujevës e jo për subjekte politike. Sa për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për pjesëmarrje në takime publike, ne jemi ata të cilës duhet ta ngrisim vetëdijen dhe të nxisim qytetarët për të marrë pjesë në takime publike, qoftë si subjekte që jemi qoftë si përfaqësues të tyre.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, informimi publik për këtë dokument meqë për këtë e kemi fjalën, është bërë në mënyrën moderne, përmes shpalljes zyrtare në hyrje të Komunës, përmes mediave, përmes ueb faqes zyrtare të Komunës (të cilën duhet që secili nga ne ta vizitojmë minimum 15 herë në ditë) dhe qytetarët e vizitojnë atë.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, po ama e vizitojmë veç ne, por jo edhe ta zëmë "ai katundari" në Orllan që nuk hyn fare në ueb faqen e Komunës.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, i drejtohet parafolëses, sërish jeni duke i nënçmuar qytetarët, sepse edhe në fshatin e largët Reçicë ose në Uglarë, menjëherë mund të hapësh Facebook-un, por edhe ueb faqen e Komunës dhe të merrni informatat e nevojshme, andaj nuk jam në dakord me atë që u tha. Mendoj se jeni duke shkuar në formën primitive (i drejtohet anëtarëve nga radhët e LVV-së) shembull, kur thoni përse nuk keni dërguar një letër në shkollën e Lluzhanit. Unë e them se në formën moderne i kemi informuar qytetarët përmes teknologjisë informative në ueb faqen zyrtare të Komunës duke përfshirë edhe atë në Facebook, andaj informimi është shumë i mirë, në rregull dhe modern, por nëse ju mendoni ashtu, të mbetet ashtu.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, konsideroj se diskutimi për këtë pikë përfundoj, andaj e hedh në votim këtë duke përfshirë edhe korrigjimet e cekura dhe të dorëzuara me shkrim nga ana e drejtorit të DBF-së.

Me 7 vota për, 2 vota kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me konstatim që të bëhen korrigjimet teknike përkatësisht barazimet e shumave buxhetore të prezantuara nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, dhe të dorëzuara në formë fizike tek shërbimi i Kuvendit, si vijon:

Nr.	kodi	Emërtimi i projektit	granti	Të hyrat	totali
7		Shenjëzimi (horizontal dhe vertikal)	30,000		30,000
9		Investimet kapitale për raste emergjente	35,000	18,975	53,975
15		Rregullimi i infrastrukturës së varrezave	58,000		58,000
19		Kolektorët e ujërave të zeza – vazhdimet	155,000	10,000	165,000
21		Ndërtimi i urave (Pollatë, Zakut, Repë, Pakashticë e Epërme)	60,000	10,000	70,000
24		Riparimi i Infrastrukturës përcjellëse në rr. Të asfaltuara (kana.atmo., bankinat, kalesat, etj)	37,000		37,000
25		Ndërtimi i kanal. fekal në lagjet e fshatrave (Gllamnik, Siboc i Poshtëm)	30,920		30,920
26		Rregullimi i Rrugëve të reja me zhavor	115,000		115,000
30		Rregullimi i hapësirave publike	42,000	10,000	52,000

-në faqe 24 të KAB, te Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, projekti me nr.rendor 1 ndryshon, dhe atë:

Nr.	kodi	Emërtimi i projektit	granti	Të hyrat	totali
1		Ndërtimi i Qendrës Rinore	100,000		100,000

-në faqe 27 të KAB, te Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, projekti me nr. rendor 1 ndryshon, dhe atë:

Nr.	kodi	Emërtimi i projektit	granti	Të hyrat	totali
1		Biblioteka e qytetit	100,000		100,000

Gjithashtu me konstatim që këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, t’iu shpërndahen Ekstraktet e procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore të mbajtura në fshatrat Kërpimëh dhe Lluzhan si dhe nga dëgjimi buxhetor i mbajtur në Sallën e Kuvendit të Komunës.

3. Propozim Statuti për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës nr.01-1/298-10 të datës 12 tetor 2009 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimet e Kuvendit të Komunës nr.01/15-10 të datës 30 janar 2012; dhe nr.01/42-10 të datës 29 shkurt 2012.

- Raporti i Komisionit

- Propozimi i dokumentit final të Statutit të Komunës (me tekstin e spastruar).

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, kemi të bëjmë me punën e Komisionit përkatës të ngritur nga ky Kuvend i cili sa jam i informuar ka punuar mjaftë shumë rreth plotësimit ndryshimeve të statutit të Komunës dhe si përfundim ka sjellë dokumentet përkatëse të cilat i keni marrë me materialin e Kuvendit, andaj e hapi debatin.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSh dhe anëtar i Komisionit Statutar, theksoi, këshilltarëve të Kuvendit i është dërguar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm duke përfshirë edhe raportin e punës së Komisionit të

cilin e kemi nënshkruar të gjithë anëtarët e Komisionit, mund të them se kemi punuar në një harmoni dhe përkushtim të madh pavarësisht subjektive politike të ndryshme, andaj shpresoj se ky dokument do të shqyrtohet dhe do të sqarohen më detajisht nëse në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Dokumentet - propozimet për plotësim ndryshime të statutit i posedoni të gjithë dhe besoj se në mënyrë shumë korrekte dhe të sqaruara është përcjellë secili plotësim – ndryshim i Statutit.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne kemi marrë materialin përkatës dhe kemi vërejtur se është bërë një punë e mirë sa i përket propozimeve për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës, andaj e përkrahim këtë dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e përgëzoj Komisionin përkatës për punën që e ka bërë, besoj se këto plotësim ndryshime janë bërë në harmoni me legjislacionin në fuqi. Më ka bërë përshtypje neni 33.8 tek të drejtat dhe detyrat e këshilltarëve të Kuvendit përkatësisht ku thuhet kompensimi financiar i këshilltarëve të Kuvendit anëtarëve të Komiteteve përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës, dua të them se kjo figuron nga dokumenti aktual që ka qenë por tani kanë ndryshuar gjërat sepse janë miratuar dhe nxjerrë edhe shumë akte tjera nga niveli qendror, mendoj se duhet të jetë në pajtim me ligjin, dispozitë kjo e cila nuk ka gjet mirëkuptim tek Ministrinë përkatëse dhe asnjëherë nuk ka mund të zbatohet, por tani sa jam në dijeni është në procedurë e sipër ligji i cili do të rregulloj këtë çështje.

Pra fjala është se do të ishte mirë të thuhej, konform legjislacionit përkatës për paga në fuqi, sepse çdo herë nuk mund të bëjmë ndryshime statutare.

U kosntatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Propozim Plani vjetor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB në Podujevë për vitin 2018

z.Avni Fetahu, theksoi, sugjeroj që tek pika e 13, përveç informatës për gjendjen e pyjeve, do të ishte mirë të përfshihej edhe informatë për gjendjen e bletarisë në Komunën tonë sepse është shtuar një numër i madh i bletëve. Ka informata për ardhjen e bletarëve më të mëdhenj që janë të cilët po lëvizin nëpër rajone të ndryshme e që mund të përcillet edhe me sëmundje të ndryshme eventuale, mirëpo është një rregull ligjore që ata fillimisht duhet të paraqiten në Drejtorinë përkatëse, pastaj ata që kullosin bletët e tyre që janë nga Komunitet tjera, të kërkohet të respektohet ligji i caktuar. Pra do të ishte mirë të bëhej një informatë për gjendjen e bletarisë në Komunën e Podujevës, dhe koha ideale është muaji shtator.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSh dhe koordinator i KKSB-së në Komunën e Podujevës, theksoi, falënderoj parafolësin për sugjerimin e dhënë, ju njoftoj se është ngritë një grup punues për hartimin e këtij draft plani të cilin mund ta pasuroni dhe ju, mirëpo sa i përket asaj që parafolësi e tha, duhet të analizohet sepse KKSB ka të bëjë me sigurinë e qytetarëve kurse sa ndikon ajo që u tha mbetet të analizohet sa është KKSB kompetente. Megjithatë jemi të hapur për propozime, sugjerime e juaja.

z.Fitim Haziri, theksoi, sa mbaj mend më parë z.Rafet Llapashtica pati kërkuar një raport të punës së këtij Këshilli për vitin 2017, e që nuk është sjellë ende. Sa i përket këtij propozim plani ne kemi vërejtur se shkaktimit të zjarreve i është dhënë përparësi më shumë se sa aksidenteve që tani vetëm po shtohen, edhe për faktin që tani jemi në fluksin e rritjes së numrit të veturave që vijnë mërgata e që pothuajse ndodhin aksidente çdo ditë. Pra për këtë arsye ne e kundërshtojmë këtë plan.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, (i drejtohet parafolësit), a e kundërshtoni planin në tërësi apo vetëm në pika të caktuara sepse nga ajo që u tha paraprakisht nuk kuptohen arsyet pse jeni kundër, apo ndoshta keni vërejtje vetëm në pika të caktuara.

z.Fitim Haziri, theksoi, përgjigje, për shkak të mos përfshirjes së një pike rreth aksidenteve ne e kundërshtojmë në tërësi këtë propozim plan. E them këtë sepse ka vende ku vazhdimisht ndodhin aksidente dhe nuk ndërmerret asgjë.

znj.Fatlume Jaha, parafolësi mund të jap propozim, të sugjeroj dhe të jap vërejtjet e veta për pika të caktuara ose për propozim planin si tërësi, por në bazë të asaj që e tha nuk janë të qarta arsyet e kundërshtimit sepse mund të propozoj pikë të caktuar për përfshirje në plan, andaj kërkoj të jemi më të qartë në qëndrime.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mund të shikojmë se çka është përfshirë dhe çka jo në propozim plan dhe të japim rekomandimet tona, në fakt plani i KKSB-së duhet të jetë sepse është edhe obligim ligjor.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, meqë plani i KKSB-së është obligativ, si i tillë fillimisht është miratuar në KKSB dhe është dërguar për miratim në Kuvendin e Komunës e që mund të jepni propozime, sugjerime etj. Rreth fatkeqësive në komunikacion vazhdimisht trajtohet kjo çështje në KKSB dhe e vëreni se informata është paraparë në muajin tetor, konkretisht për problemet në komunikacion në çdo takim raporton Komandanti i Stacionit të Policisë, andaj kjo që u cek veç është e rregulluar. Sa i përket punës së KKSB-së, keni vërejtur se zakonisht në fund të vitit ngritën grupe të caktuara punuese të cilat përgatitin informatën për punën e KKSB-së e cila dërgohet në Kuvend për informim, dhe në këtë kontekst shumë shpejt do t'jua përcjellim edhe informatën e KKSB-së për punët dhe aktivitetet për vitin 2017, ndoshta paksa me vonesë por kjo është e arsyeshme sepse vetë KKSB është themeluar ndoshta me vonesë për arsye tash më të ditura. Gjithashtu kemi biseduar dhe jemi dakorduar me Komandantin e Stacionit të Policisë i cili do të raportoj në Kuvendin e Komunës për gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës një ose dy herë në vit varësisht nevojave. Pra ne kemi mbajtur dy takime brenda një jave vetëm për të zënë afatet e planeve dhe informatës së kërkuar si dhe me qëllim të mbajtjes së tri takimeve në gjashtë mujorin e parë të vitit, andaj planifikojmë që në seancën e radhës të sjellim informatën e cekur sepse pa dal në KKSB nuk mund të sillet në Kuvend.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, këtë që e ceku drejtori parafoles e kemi biseduar edhe më parë dhe ju kam thënë se kurdo që ne merremi vesh ne këtu në KPF mund t'i rekomandojmë Kuvendit që të thërrasim Komandantin e Stacionit të Policisë që të informoi Kuvendin e Komunës për gjendjen e sigurisë dhe çështje tjera me rëndësi të cilat janë në detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Jemi në dijeni se themelimi i KKSB-së është vonuar për shkak të themelimit të Komitetit për Komunitete i cili është vonuar paksa si shkak i përfaqësimit gjinorë në atë Komitet.

z.Fitim Haziri, theksoi, unë e jepe rekomandimin rreth kësaj çështje, si dhe njëkohësisht jemi kritik për punën e këtij Këshilli.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, parafoles tha se jemi kritik për punën e KKSB-së, mirëpo fillimisht duhet të jetë i informuar për punën e KKSB-së në vitin e kaluar dhe nuk besoj që është në dijeni fare se çka ka punuar KKSB në vitin 2017, andaj duhet të ketë informatën e pastaj të diskutojmë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, konsideroj se së pari duhet të sjellët informata e KKSB-së pastaj mund të diskutojmë rreth punës së këtij Këshilli.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, fillimisht uroj që ky Këshill të ketë punë sa më pak, për arsye se ka të bëjë me sigurinë dhe kur është në pyetje kjo del të kemi punë me gjëra të dhimbshme siç janë aksidentet, zjarret, vërshimet, radikalizma të ndryshëm fetar etj. Ne jemi të vetëdijshëm se KKSB është obligative të themelohet, kryetar i tij është Kryetari i Komunës si dhe bëjnë pjesë organet – institucionet më të larta në nivel lokal siç është edhe Komandanti i Stacionit të Policisë, FSK, Kryetari i Bashkësisë Islame si dhe zyrtar dhe përgjegjës tjerë të institucioneve tjera relevante, në mënyrë që situatat të jetë në kontroll, nuk dyshoj se organet e rendit dëshirojnë të kenë punë sa i përket sigurisë. Mendoj se probleme të mëdha në Komunën e Podujevës nuk ka dhe kjo është falë kontributit të të gjithëve pa përjashtim të ndonjë subjekti politik apo organi komunal, e them këtë për arsye se kemi ruajtur nivelin e komunikimit të përgjithshëm

qoftë politik, fetar, të sigurisë etj, sepse asnjëri prej nesh nuk kemi dëshirë të shohim ndokënd keq në këtë drejtim, sa do që flasim nuk mund të jemi askush ndaj askujt më i dhimbshëm, por është mirë të ndërmarim masa në mënyrë që të zbusim numrin e aksidenteve dhe në këtë aspekt ta kemi një raport për trafikun në territorin e Komunës së Podujevës në mënyrë që në disa akse rrugore të cilat janë më të shpeshta me aksidente të propozojmë ndonjë preventivë siç janë rruga Podujevë–Sfeçël–Shajkoc, pastaj rruga Podujevë – Peran, e të tjera, pra të ndërmarim diçka në këtë drejtim qoftë me “policë të shtrirë”, qoftë me patrullime më të shpeshta të Policisë e të tjera sepse tani veç kemi hyrë në verë dhe natyrisht është edhe sezoni i ardhjes së mërgimtarëve tanë nga shtete të ndryshme dhe numri i vetura në komunikacion sa vjen e shtohet. Sa i përket fushës së Bashkësisë Islame në Podujevë qëndrojmë shumë mirë dhe jemi të kënaqur me punën e tyre qoftë sa i përket rrezikut të radikalizmit qoftë në aspekte tjera e që është kontribut i të gjithë neve, përndryshe është e vërtetë që unë kam kërkuar raport – informatë për punën e KKSB-së për vitin 2017, pastaj jemi të vonuar edhe me planin e punës sepse jemi në muajin e gjashtë e që në fakt do të duhej të kishim raportin gjashtëmujor, mirëpo si do që të jetë ky dokument duhet të shkoj në Kuvend dhe pastaj aty të diskutojmë edhe më gjerë ku secili prej nesh mund të jap propozime, sugjerime dhe vërejtje në planin e punës së KKSB-së për vitin 2018, gjë të cilën mund ta bëjmë dhe sot, në të kundërtën ne mund të jemi kundër sot këtu, por është mirë të japim kontribut secili sa i përket gjendjes së sigurisë, përndryshe për çdo pikë që diskutojmë nëse nuk kemi propozime por vetëm themi se “nuk është mirë” mendoj se është shumë hipotetike. Pastaj nëse nuk e përkrahim këtë plan të punës apo nëse nuk e konstituojmë KKSB-së mandej nuk kemi prej kujt të kërkojmë llogari pastaj, sepse dalim si të painteresuar për një gjë të tillë. Prandaj kërkoj që nëse kemi diçka për shtuar në këtë plan, ta bëjmë dhe në këtë aspekt meqë z.Faik Muçiqi Drejtor i DSHPMSh është edhe koordinatori i KKSB-së, kërkoj që në raportin e ardhshëm të kemi një statistikë të aksidenteve, vdekjeve në trafik, zjarreve dhe aspekteve tjera që ndërlidhen me sigurinë. Shembull, mes fshatrave Koliç - Dyz është krijuar një deponi e egër e mbeturinave në vendin ku është marrë zhavorr – dhe, me rastin e rregullimit të rrugës ku ka mbet një gropë e madhe në të cilën hedhen eshtrat dhe pjesët tjera të kafshëve nga mishtoret e Podujevës dhe mbeturinave tjera, andaj është edhe kërkesë e komunitetit që të ndërmerret diçka në këtë drejtim qoftë nga Komuna qoftë nga Kompania “Pastrimi”, të inspektohet fillimisht dhe të vendoset tabela përkatëse nga Drejtoria e Inspeksionit e cila paralajmëron ndalimin e hedhjes së mbeturinave, pra kjo gjendje hynë në aspektin e sigurisë sepse mund të ndodh ndonjë epidemi në ato lokalitete, kërkoj falje që ndoshta kjo pjesë ishte paksa jashtë temës, përndryshe si dokument i rekomandoj Kuvendit për shqyrtim dhe njëkohësisht kërkoj nga të gjithë këshilltarët e Kuvendit që të japin kontributet e tyre sa i përket përmirësimit të sigurisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Podujevës. Unë nuk e kam parim që të dal kundër ndonjë dokumenti veç pse thotë ndonjë prej anëtarëve të KPF-së në këtë rast apo ndonjë këshilltari të Kuvendit, por shprehi mendimin tim dhe të Grupit të këshilltareve që përfaqësoj, madje ndodh që të jem edhe kundër ndonjë këshilltari të subjektit që i takoj sepse kemi të bëjmë me demokraci ku secili shpreh mendimin e tij personal.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, meqë nuk pati diskutues tjerë, shtoi, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t’i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

5. Njoftimi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë për zëvendësimin e përfaqësuesit të Bashkësisë Islame, në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës sigurisht e keni lexuar dhe analizuar materialin përkatës konkretisht kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, andaj nëse keni diçka për të shtuar, urdhëroni nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, përkatësisht miratimin e kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, për zëvendësimin e anëtarët – përfaqësuesit të tyre në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

Mbledhja përfundoi në orën 14:55

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0050581/18
Podujevë,
28 qershor 2018**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**